

Komunikatë për shtyp mbi rastin e mjekëve të Spitalit Psikiatrik, Vlorë

Dr. Din Abazaj
President i UMSH-së

Janë tre mjekë të pezulluar nga Ministria e Shëndetësisë, të cilët i përkasin Spitalit Psikiatrik të Vlorës. Ndër këtë të tre, është edhe Drejtoresha e këtij Spitali, e cila është shkarkuar nga detyra.

Aktualisht janë në hetim dhe verifikim nga organet e drejtësisë.

Në këtë rast, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë pret përfundimin e këtyre hetimeve nga organet përkatëse. Në qoftë se vërtetohet mitmarrja, masat ndëshkimore nga Urdhri i Mjekëve do të jenë maksimale, dmth heqja e Liçensës.

Dua të theksoj se në Urdhrin e Mjekëve, nuk ka mbërritur asnjë denoncim konkret për mitmarrje, ndonëse është një fenomen i shumë përfolur.

Sigurisht nëse do të na paraqiten ankesa për këtë problem, nuk do të hezitojmë për masat me ekstreme, heqje të liçensës, dmth heqje të të drejtës për të ushtruar profesionin.

Është tepër i përfolur korrupsioni në bluzat e bardha. Nuk e mohojmë ekzistencën e tij, ndonëse jo në përmasat që përflitet, sepse janë individë dhe jo të gjithë bluzat e bardha të korruptuara. Korrupsioni në bluzat e bardha është pjesë në kontekstin shoqëror dhe luftohet e korrigjohet bashkë me të.

Në këtë rast, do t'ju bëja apel jo vetëm mjekëve, por edhe të sëmurëve dhe publikut, ju mediave që të bëheni bashkëlufëtare kundër këtij fenomeni shumë të rrezikshëm e të turpshëm për bluzat e bardha.

I ftoj qytetarët të mos bëhen pjesë e korrupsionit dhe të mos fusin duart në xhep kur shkojnë tek mjeku.

Të kenë besim në profesionalizmin e mjekëve dhe të denoncojnë ata të cilët shkelin këto norma etike.

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.